

Epistular 1951-1964: Jup Kastrati - Justin Rrota,
kujdesoi botimin Fatmira Kastrati (Sykja), Albans, Tiranë 2024,
ISBN 9789928920133, 666 ff.

Fondacioni Jup Kastrati ka përgatitë së fundi botimin e epistularit mes gjuhëtarit shkodran dhe Át Justin Rrotës, studiues e gjuhëtar në za i aradhës françeskane që dha një kontribut të çmueshëm për kulturën tonë gjatë shekullit XX. Epistulari është kujdesue me akribi shkencore nga e bija e prof. Kastratit, Fatmira Kastrati (Sykja) së bashku me prof. Diana Kastratin, e cila ka dhënë një kontribut me peshë në pajisjen me aparat kritik të veprës. Çdo letër është sjellë me besnikëri, me respekt për grafingë e secilit, me sqarime citimet në gjuhë të ndryshme, terminologjinë specifike e ku ka qenë e mundur deri edhe personat për të cilët bahet fjalë.

Është një korrespondencë 13-vjeçare të përbërë prej 271 letrash që hedh dritë direkt mbi një raport dinamik intelektual që e ka zanafillën si marrëdhënie mes dishepullit dhe pedagogut dhe vijon si dialog me kolegësh.

Kur bahet fjalë për epistulare kemi parasysh distanca të konsiderueshme hapsinore. Në këtë rast distanca nuk është hapsinore por shumë më komplekse, e çka është me rëndësi ky kompleksitet anulohet thjeshtë prej vullnetit të dy njerzve të shkencës që afrohen me njëri-tjetrin përtej përkatësisë së tyre të origjinës dhe rrethanave historike. Hapsina që i ndan është krejt e vogël. Rruga prej te Arra e Madhe ku ndodhet kuvendi françeskan deri tek shtëpia e prof. Jup Kastratit nuk është ma se dhjetë minuta në biçikletë, por largësia është e një natyre tjetër, të cilën regjimi komunist ka kontribue me e shndërrue në një frakturë mohuese. Diçka ndodhë, e kështu hyn interesi, kurioziteti, guximi i Jup Kastratit për me kërkue pikëpërjet, konvergjenca, vijueshmërinë, frymëzimin tek pararendësit. Dialogu në distancë zhvillohet në kushtet e mundësisë për një afërmim me brezave të studiuesve dhe me parakushtin esencial të dashënisë së pamasë për gjuhën shqipe. Krahës letrave me dy gjuhëtarëve shkodran, kemi edhe letra të Aleksandër Xhuvanit, Llazat Siliqit, Maximilian Lambertz-it, Mark Gurakuqit.

Në këtë epistular, gjuhëtar i ri Jup Kastrati del si një studiues i zellshëm, i vemendshëm, biramel, i njerzishëm dhe i papritueshëm, i gatshëm me iu gjetë fratit të mëdëm dhe të sëmurë libra e studime, madje i zoti me i raditë deri edhe letër dhe shirit makine shkrimi. Në korrespondencën me tyre ka një përshtatje të ndërsjellë, të dy shkruajnë me i ardhë rreth njëri-tjetrit. Rrota në izolimin e tij traumatik shihet se nuk e ka krejt të qartë faktin se klima politike nuk ka ndryshue vetëm në shoqëri dhe në politikë por edhe

në shkencë. Jupi ia çilë sytë me takt tue e ndihmue me kuptue njikohsisht se në fushën e shkencës ka gjithnji njerëz dashamirës që me aq sa munden ruejnë vlerat njerzore dhe e mbajnë të ndame ideologjinë prej shkencës.

Ky letëkëmbim asht një objekt studimi që shkon përtej dimensionin biografik të dy gjuhëtarëve dhe përfshin elemente të mirëfillta shkencore, historike, urbane, fetare, qytetare. Me anën e këtyne letrave rindërtohet një segment i asaj epoqe, i pamë prej një vëzhguesi të ngujuem te Arra e Madhe e prej një tjetri në lëvizje. Nuk kemi të bajmë me ushtrime stilit ku dy intelektualë i tregojnë njëni-tjetrit për vetveten, por për një nevojë të thellë për me komunikue esencialen në një kohë kur esenciale asht ba vetëm “conatus sese servandi”.

Shkaku i këtij letëkëmbimi asht gjuha shqipe dhe librat, dy dashuni të mëdhaja si për njënin ashtu edhe për tjetrin. Librat janë merakut ma i madh i Át Justin Rrotës, në një rrëfim të paplotë ai flet për librat e djegun prej familjarëve, për librat e dorëzue, librat e humbun, librat e lanun në përdorim, librat që ai mton me i marr mbrapsht prej pushtetit që ia ka sekuestrue. Kastrati flet për librat që merr uha prej kolegëve, prej bibliotekave, miqve, për mundin me i lexue me ngut tue marrë shenjime, për etjen për dije.

Në atë epistular rrahen çeshtje që sillen prej historisë së letërsisë dhe gjuhës shqipe, tek fonetika historike, etimologjia, leksiku, morfologjia. Rrota asht konservator edhe në krahun të cilit i përket. Parimet e tija në gjuhësi janë të ngulta dhe mbizotnojnë elementat historikë e jo ata dinamikë që ndjekun zhvillimet e shqipes. Libri dhe gjuha shqipe i bajnë miq fratin françeskan dhe studiuesin e ri që i përket një dimension tjetër shoqnor. Kjo miqsi ban që Jupi me zellin e dishepullit t’i sigurojë fratin gjuhëtar letër shkrimi, shirit makine, libra, përkthime, artikuj, recensione. Gjithashtu ai përcjell në letra tablo të jetës shkencore në Tiranë, përshekruen në detaje konferenca shkencore, risjell biseda e kumtesa me interesë për Rrotën, përshekruen lista me botime të hueja, ban përditësime të plota. Ndërsa Át Justini i jep këshilla, porosi për miqtë në Tiranë, kërkesa pafund (herë mbas here shkruen: (“jam ba i mërzitshëm e i randë”). Disa prej këshillave janë me shkue në Ljarje për me gjurmue gjuhën e *Mesharit*, këshilla për Xhuvani mos me përdorë foljen “me futë” pse asht e pangjashme në përdorim, tue pasë parasysh etimologjinë e saj. Gjithashtu gjejmë këshilla për komisionin e ortografisë në nandor të vitit 1953. Jupi kryen detyrën e ndërlihdjes me Çabejn, Xhuvani, Siliqin, Gurakuqin, Domin. Nga ana tjetër i kërkon uha apo edhe me ble libra që mund t’i kenë teprue atij apo miqve të tij.

Letrat e Jupit janë të mbushuna me terma e citime latinisht, greqisht, italisht, gjermanisht, turqisht, shihet tek ai eruditi, gjuhëtar dhe filologu. Intimitetit miqsor i shtohet edhe miqsia e hymje-daljet mes familjes

Kastrati dhe vëllait të P. Justinit, piktorit Simon Rrota. Janë hymje-dalje që kanë si shkak festa fetare, gëzime familjare. Letrat janë të drejtpërdrejta por dorëzimi i tyre bahet me korriera të cilët zakonisht janë të përzgjedhun prej Át Justinit e bahet fjalë për Kolec Çefën, Simon Pepën, Kolec Pepën, Rrok Gjellucin, Paulin Vjerdhën.

Jupi ka për “detyrë” me pyet të jatit që fjalë të turqishtes që i interesojnë Patër Justinit, nganjherë kërkesat e këtij të fundit janë thuejse absurde, mbasi mëton me gjetë krajanë mundësisht të pashkodranizuem krejt për me i pyet për fjalë të asaj treve! Kastrati nga ana e tij e mban në korrent për aktivitetet shkencore që bahen në kryeqytet aq sa mund të themi se P. Justini merr pjesë rregullisht në distancë në ato tubime e konferenca. Nganjherë përmbledhja që ai i ban psh. Konferencës së Ortografisë asht aq e përpiktë sa mund të merret për një recension *ad hoc*. Nga ana tjetër Kastrati shpreh respektin ndaj fratis të moçem për kontributin e tij për arsimin dhe kulturën tue ndërhy për te tek autoritetet e kohës për vlerësimin e tij si arsimitar i vjetër. Nga ana tjetër Jupi bahet ndërlidhës me Lambertzin për me dijtë ndonji gjë për të vëllain e P. Justinit, Kolë Rrotën, që jeton në Vjenë qysh para Luftet. Besimi mes tyre rritet aq sa Rrota i jep Kastratis dorëshkrimin e shtatë shkronjave të para të *Fjalorthit të Huazimeve*. Ndërkaq frati ankohet se gjuha po bdaret dhe ngarkon Jupin me mbrojtë në forumet shkencore në Tiranë tezën e gjatësisë së zanores. Tek ajo që mund ta quejmë rubrika “lajme prej Tirane”, Jupi i jep kumtin e daljes së Fjalorit të vitit 1954, atë të botimit të *Sintaksës* së Domit, lajmin që Rrota asht citue nga Enciklopedia sovjetike, i rreshton studimet e lingvisteve sovjetike si Desnickaja e Kotova, për të cilat françeskani tregon shumë interesë.

Mosha dhe shëndeti i keq i Át Justinit, gjysëm paralitik, janë të pranishme në letra. Ai ndihet i izoluem në fund të qytetit dhe e vetmja dritare me botën shkencore për ma se një dekadë asht komunikimi me Jup Kastratin. Françeskani i ankohet për hymje-daljet e kufizueme që ka, për faktin se pakkush shkon me e takue, por i flet edhe për të kaluemen, për andrrat dhe punën e përkushtueme për rininë. Jupi i përmendë gjithnji raportet miqsore familjare me të vëllanë, Simonin, dhe i tregon se letrat e tija i lexojnë bashkarisht në familje. Afrimiteti dhe përzemërsia ndihen ma fort në rasa festash kur Át Justini i uron Bajramin e Jupi i uron Krishtlindjen. Nji tjetër personazh që del shpesh në ato vite asht edhe Llazar Siliqi, i cili përtej postit që mban si deputet i Shkodrës, i drejtohet në letra me “i nderueshmi Át Justin” e jo “zoti Justin” siç i shkruajnë të tjerët. Siliqi i dhuron shirit makine nepërmjet Prenk Jakovës e Ndoc Shllakut, madje shkon me e takue së bashku me Sterjo Spassen e Teufik Gjylin në kuvend.

Nga ana tjetër Át Justin Rrota tregon në ato letra edhe karakterin e plakut që nuk kufizohet vetëm tek ankesat për shëndetin e keq, por del në pah

edhe nostalgjia e së kaluemes, kujtimet e tija për sjelljen në atdhe në vitin 1929 të riprodhimit të veprës së Buzukut. Këto kujtime, me interesimin e Jupit dhe të tjerëve, do të botohen tek revista “Nandori” në vitin jubilar të *Mesharit* 1955.

Marrin e japin libra pafund, mes tyne: Tagliavini, Cimochowski, Haebler, Gjeçovi, La Piana, Lambertz, fjalorë, recensione, artikuj etj. Prej letërkëmbimit del se Jupi mban një epistular edhe me P. Benedikt Demën, ndërsa P. Justini i tregon se ia komunikon materialet edhe P. Viktor Volajt, latinist e gjuhëtar i vlerët, i cili asht i ndërlidhun me Çabejn. Jupi e informon për gjithçka, deri edhe për udhëtimet e Xhuvanit në Rumani, të Domit në DDR, por edhe P. Justini kah ana e tij i len me kuptue se asht i informuem e kur Jupi nuk duket andejpari e din se o asht me flamë, o asht me provime ose me shërbim në Tiranë. Në letrat e tyne nuk mungojnë as kodet në komunikim, psh. P. Justini i shkruen *se era, posaçe veriu, që rreh fort këtu tek un, më ka sjellë do lajme*. Jupi i kopjon me makinë shkrimit recensione, vlerësime artikujsh, pjesë librash, i riprodhon faqe të tana të La Piana, i përkthen Desnickajen, madje tue përdorë dy përkthyes të ndryshëm, së pari një farë Halit Isufi, e mandej Fehmi Gokajn. Letrat janë të ethshme e kuptohet se kajherë profesori i ri nuk mbërrin me i ndejt ritmeve të françeskanit që sapo e merr veten prej sëmundjes lëshohet në punë. Letrat e Jupit kanë edhe karakter autobiografik, ai i tregon se po punon për De Radën, Gaspër Palin, për bibliografinë e gramatikave, ndërkaq i çon me lexue artikuj të tijtë për me pasë gjykime kritike e jo lavde. Gjithashtu Kastrati i tregon për punët që ka në proces: Konicën, Mjedjen, Kolë Mirditën, Gaspër Palin (punën për të cilin e quen “detyrë shpirtnore”). Jupi asht edhe ndërlidhës zyrtar me Institutin në Tiranë: nepërmjet tij Xhuvani e ma vonë Kostallari i kërkojnë bashkëpunim, artikuj, i çojnë ftesa siç asht ajo për Konferencën e Studimeve Albanologjike të vitit 1962.

Patër Justini i tregohet mirënjohës e nuk priton me shkruë: “të jam ndë detyrë, sa të rrnoj... ardhhtë rasa e bukur per me t’a shpërblye disi”, “lutem për ty *nominatim...*”, “ta shpërblefsha me një kujtim të përhershëm miradijet”.

Me kalimin e viteve Jupit piqet si individualitet shkencor, shihet autostima e tij, por edhe lodhja e ngarkesa, kajherë ndihet ligështimi, sidomos kur vëren se koha kalon shpejt, fluturon, e i duket se s’po ban gja – e me mendue se asht vetëm 33 vjeç!

Jupi i ban edhe përshkrime konferencash, forumesh por edhe ceremonish publike edhe në qytetin e tyne, siç asht për shembull ardhja e eshtnave të Gurakuqit në Shkodër me 21.11.1957.

Ndër ato letra ndihet edhe përceptimi i asokohshëm i hapsinës urbane: *Kuvendi i Arrës së Madhe e Parruca janë afër në kambë, por ti biçikletën e din*, e ngacmon frati i moçëm, e turru me biçikletë. Tue ndejtë tek hapsina

urbane, edhe shkuemja e Jupit në Tiranë përban një event: kam shkue dy herë në dhjetë ditë i shkruen ai P. Justinin, e sigurisht frati merr parasysh këtë impenjim të profesorit të ri.

Në letërkëmbim dalin edhe çështje të randësishme si asht ajo e dorëshkrimeve të *Gramatikës* së Gurakuqit, dorëshkrimet e veprave *Gjuha e shkrueme* dhe *Ditën e mbrame të Turkis në Shkodër*.

Ndërkaq vitet kanë kalue e del në pah lodhja e Át Justinin, harresa, padurimi, frika, ngulmimi, mosha e sëmundja e kanë ba të veten. Megjithatë ai s'pran së shkruemi, kryesisht për veprën *Gjuha e shkrueme*, por flet edhe për kujtimet e rrethimit të Shkodrës. Të dyja këto vepra do të botohen falë Atë Zef Pllumit në vitet 2000.

Nuk mungojnë divagacionet, Át Justini që asht një vrojtues si pakkush i shkruen se ditëlindja e Jupit dhe emni i tij, shën Justini, përkojnë me datën 14 prill.

Edhe në letrat e tija Jupi sheh gjithçka në detaj, psh. shkruen me të madhe fjalën "Krishtlindje", kurse me të vogël "viti i ri", ose dallon "shokët "e Tiranës prej "miqve" të Shkodrës.

Jupi e informon për Konferencën albanologjike të vitit 1962, për ardhjen e Franz Babinger, Vittore Pisani, Treimer-it, Svane-s, i përshkruen në detaj gjithçka. P. Justini e pyet pa shumë shpresë nëse janë marrë parasysh oroenat e tija kritike, nga ana tjetër e gëzon botimi i "Shkodra 1962" dhe pret me gëzim daljen e shpejtë të Buletinit të Institutit (1963).

Kemi mbërrijtë në vitin 1962: françeskani asht ende i kthjellët dhe Jupi e pyet për tekstin *Kangë popullore gegnisht* të vitit 1911 se kush asht autori: Prensushi apo Gjeçovi. Át Justini i përgjigjet se asht kryesisht Fishta.

Át Justini asht i lodhun, s'ka shpresë me e pa të botueme veprën "Gjuha e shkrueme", asht i mërzhitur e i ankohet Jupit se s'i ka shkue me e pa as Gegë Marubi.

"Jam me një kambë në vorr", vijon në letra, tue theksue se asht paralitik, i sëmurë, e për këtë arsye i kërkon falje se e ka rrallue korrespondencën.

Ndërkaq Jupi ka krijue fizionominë e tij si studiues, letrat mes tyne janë rrallue por interesi nuk ka pra.

Ky libër i kujdesuem me cenë e me dashuni tregon takimin në kushte të vështira historike mes dy intelektualëve, njëni i përkiste një kohe të perëndueme e të lavdishme kur Kisha katolike ishte pararojë e dijes, tjetri përfaqson të renë që beson se drejt së ardhmes në shkencë shkohet pa fraktura me të kaluemen, por me vijimsi dijet dhe virtytesh.

Ardian Ndreca